



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 14.11.2023

Nr: 816

Ora: 12.00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR
SUBJEKTIN VETËDEKLARUES, ZOTIN KRESHNIK RIZA HAJDARI, KRYETAR I BASHKISË KUÇOVË,
I PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR “PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË”**

Sot në datën 14. 11.2023, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues, z. Kreshnik Riza Hajdari, kryetar i Bashkisë Kuçovë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

Palë të interesuara: Z. Kreshnik Riza Hajdari, kryetar i Bashkisë Kuçovë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Baza ligjore: Neni 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; nenet 90 dhe 95 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, i ndryshuar, ligji nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; pikat 12 dhe 13 të kreut V të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J:

(1)

Në bazë të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike, si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe “Kandidati/Kryetar Bashkie”.

Në bazë të nenit 5 të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, zoti Kreshnik Riza Hajdari, si kandidat për kryetar të Bashkisë Kuçovë, i mbështetur nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, ka depozituar në KQZ në datën 02.04.2023 formularin e vetëdeklarimit. Ky formular është regjistruar nga KQZ-ja me numër unik BR-PS-17366.

KQZ bëri verifikimin “*prima facie*” të formularit:

1. Nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB) për gjendjen gjyqësore të zotit Kreshnik Hajdari. Në përgjigje të kësaj kërkesë DPB-ja ka konfirmuar se ky subjekt rezulton i padënuar penalisht.
2. Po nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, KQZ-ja ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC) në lidhje me gjeneralitetet e subjektit vetëdeklarues. Në përgjigje të kësaj kërkesë DPGJC konfirmon se subjekti vetëdeklarues, zoti Kreshnik Riza Hajdari, nuk rezulton të ketë ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.
3. Verifikoi të dhënat që përmban formulari i vetëdeklarimit dhe rezulton se nuk ka të dhëna për shkaqe të cilat sipas përcaktimeve të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, zotit Kreshnik Hajdari do t’i ndalohej të kandidonte për kryetar bashkie.

(2)

Subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë” me anë të shkresës nr. 220, datë 04.04.2023 informon KQZ-në se zoti Kreshnik Hajdari është dënuar penalisht në shtetin grek.

Nxitur nga ky informacion dhe bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe në

kreun V, pika 2, shkronja "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 "Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 4100 prot., datë 24.4.2023, vendosi t'ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të të dhënave, të pasqyruara ose jo në formularin e vetëdeklarimit, kur ato lidhen me një juridiksion penal të huaj.

Me shkresën nr. 601/35 prot., datë 02.11.2023, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve vendimin "Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin zotin Kreshnik Riza Hajdari". Prokuroria e Përgjithshme, pas kryerjes së të gjitha verifikimeve përkatëse, i konsideron këto të fundit të plota dhe të bazuara në nenin 8, pikat 1 dhe 2, të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", si dhe në përcaktimet e pikës 3, shkronja "ç", kreu III, dhe pikave 10, 11, 12 e 13 të kreut V të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, ka miratuar rezultatit e verifikimit të subjektit vetëdeklarues zotit Kreshnik Riza Hajdari, sipas të cilit konstatohet si më poshtë:

1. Nuk rezulton të ketë gjeneralitete të tjera në përbërësit e gjendjes civile, përveç atyre të deklaruara në formular apo të ndryshme nga ato të deklaruara;
2. Rezulton të jetë i dënuar me vendim të formës së prerë Nr. 3286/23-6-1999, nga Gjykata e Shkallës së Parë Janinë/Gjykata Penale me një Anëtar, e cila ka vendosur:
 - a. *"Në prani të të pandehurve ...14) Kreshnik Hajdari, i biri i RIZA dhe i HALIME, i lindur më 29-7-1982 në Berat, Shqipëri, punëtor (i bashkëgjykuar i mitur): Shpall fajtor secilin nga personat madhorë të përgjegjshëm penalisht dhe shkaktar secilin nga personat e mitur të përgjegjshëm penalisht (ka kryer një vepër) për shkeljet: "Hyrja në territorin grek pa ruajtur formalitetet ligjore përkatëse" (shkelje e nenit3 dhe 4 të ligjit 1975/1991).*
 - b. *Dënon secilin nga personat madhorë penalisht të pandehur, të shpallur fajtorë me: Katër (4) muaj burgim.*
 - c. *Dënon secilin nga të pandehurit e mitur të shpallur fajtorë me: Masa riedukuese e qortimit. Konverton në dënime me gjobë të gjitha dënimet me burg të vendosura tashmë më sipër të pandehurve të dënuar (të gjithë), dhe përcakton shumën e konvertimit për çdo ditë burgim në njëmijë e pesëqind (1500) dhrahmi.*
 - d. *Urdhëron dëbimin e menjëhershëm të të gjithë të pandehurve madhorë të huaj të dënuar me burg dhe më tej pezullon për një kohë të pacaktuar (sipas nenit 90 parag.2 të Kodit Penal) dënimin me burg të dhënë ndaj tyre, me kusht që të ekzekutohet menjëherë dëbimi i tyre tashmë i urdhëruar".*
3. Nuk rezulton i dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;

4. Rezulton që në vitin 1999 të ketë qenë në gjykim nga Gjykata e Shkallës së Parë Janinë për: Hyrje në territorin grek pa ruajtur formalitetet ligjore përkatëse (shkelje e nenit 3 dhe 4 të ligjit 1975/1991).
5. Nuk rezulton të ketë qenë ndonjëherë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese për kryerjen e një vepre penale.
6. Nuk rezulton që ndaj tij të jetë caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale.
7. Nuk rezulton që ndaj tij të jetë lëshuar urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
8. Nuk rezulton që ndaj tij të jetë marrë masa e dëbimit nga një shtet i huaj.

(3)

Në përfundim të procesit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 679, datë 4.7.2023, i ka dhënë mandatin zotit Kreshnik Hajdari si kryetar i Bashkisë Kuçovë.

(4)

Në seancën publike të KQZ-së të datës 14.11.2023 për vlerësimin e rezultatit të verifikimit të thelluar të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetëdeklarues, zotin Kreshnik Hajdari, tashmë kryetar i Bashkisë Kuçovë, ky i fundit nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor, zotin Theodhori Sollaku, deklaroi se nuk ekziston asnjë shkak për ndërprerjen e mandatit të zotit Hajdari si kryetar bashkie.

Sipas tij, citoj *“në vitin 1999 (zoti Kreshnik Hajdari) është kapur nga autoritetet greke për kalim të paligjshëm të kufirit. Është bërë një procedurë që nuk dihet në është penale apo administrative, është marrë masa qortim shoqëror dhe më pas është shoqëruar jashtë territorit grek.*

Në ato vite kodi ynë nuk ka pasur vendime të tilla. Në janar të vitit 2018 është miratuar ligji për të mitur, aty janë parashikuar disa masa të ngjashme dhe në finale është parashikuar që, nëse ke masa të tilla, quhesh person i padënuar. Pra, nëse prokuroria ndesh një situatë që parashikon ky ligj, është e detyruar të mos e fillojë, por, nëse nuk e ka bërë prokuroria, gjykata duhet ta pushojë çështjen. Edhe sikur të pranohet çfarë është iniciuar, ne rivlerësojmë që nuk quhet i dënuar. Sa i përket rastit të dëbimit të vitit 2017, ne nuk kemi dijeni, se janë informacione policore, por aty është thënë që në vitin 2017 është hedhur në sistem ajo që ka ndodhur në vitin 1999”.

Zoti Altin Kazia, si përfaqësues në KQZ i Partisë së Lirisë dhe i subjektit “Bashkë Fitojmë” së bashku me përfaqësuesit e tjerë, zotin Franc Nuraj dhe zotin Arben Llangozi, kërkuan që zotit Kreshnik Hajdari t’i ndërpritet mandati i kryetarit të Bashkisë Kuçovë.

Sipas tyre, citoj *“Kreshnik Hajdari në referim të vendimit të Prokurorisë së Përgjithshme është dënuar me një vendim të formës së prerë. Përveç këtij dënimi ka dhe një masë dëbimi në 2017. Prokuroria e Përgjithshme ka bërë një lapsus në dispozitiv të vendimit duke cituar se Kreshnik Hajdari nuk ka marrë masa dëbimi nga një shtet i huaj, pra Kreshnik Hajdari nuk ka deklaruar dy masa të marra ndaj tij. Mosdeklarimi më vete përbën vepër penale dhe kanë kërkuar që Kreshnik Hajdarit t’i hiqet mandati....Dënimi mund të jetë i ulët, pak rëndësi ka. Pyetja sot është pse nuk e ka deklaruar. Kjo përbën vepër penale. KQZ ka pasur raste në të shkuarën, si Kajmaku, dhe rëndësi kishte mosdeklarimi në formularin e dekriminalizimit...*

...ajo që ne kërkojmë është pavlefshmëria dhe përfundimi i mandati të kryebashkiakut të Kuçovës”. Kujtojmë se sipas njoftimit të prokurorisë, ai rezulton i dënuar me vendim të formës së prerë nga Gjykata e Janinës. Kreshnik Hajdari është shpallur fajtor për kalim të paligjshëm të kufirit në vitin 1999 në moshë të mitur. Për këtë arsye ne vlerësojmë se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Komisioneri në këtë rast, në zgjidhjen e kësaj çështjeje duhet të mbajë parasysh ligjin nr. 138/2015 dhe t’i japë zgjidhje të drejtë kësaj çështjeje... Prokuroria në faqen 4 të vendimit të saj ka cituar se Kreshnik Hajdari është deportuar nga shteti grek. Edhe pse mendojmë se prokuroria ka bërë një lapsus në fund të dispozitivit në të cilin ka cituar se zoti Hajdari nuk ka asnjë masë dëbimi nga një shtet i huaj, zoti Hajdari të na thotë sot nëse është deportuar nga shteti grek në vitin 2017...”

Zoti Kaziaj dhe bashkëpërfaqësuesit me të kanë pretenduar gjithashtu se fakti që subjekti Kreshnik Hajdari nuk e ka deklaruar në formular dënimin e marrë nga gjykata përkatëse e shtetit grek përbën shkak për ndërprerjen e mandatit të tij. Sipas tyre ky pretendim gjen mbështetje edhe në vendimin e Gjykatës së Lartë me nr. 215, datë 24.7.2023 në të cilin përcaktohet (paragrafi 22) se *“...subjektet vetëdeklaruese kanë detyrim të pasqyrojnë në formular çdo dënim penal të formës së prerë, i dalë në zbatim të ligjit nr. 138/2015.*

Në referim të provave dhe vendimit të Gjykatës së Lartë i kërkojmë Komisionerit të shpallë të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të kryetarit të Bashkisë, zotit Kreshnik Hajdari.”

(5)

KQZ-ja vlerëson se për subjektin vetëdeklarues, zotin Kreshnik Hajdari, nuk ekziston ndonjë shkak, i cili sipas përcaktimeve të ligjit nr. 138/2015 *“Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”* bën t’i ndërpritet mandati i kryetarit të bashkisë.

Ky ligj ka përcaktuar shkaqet/rastet kur një person ndalohet të kandidojë apo edhe të ushtrojë detyrën e kryetarit të bashkisë. Sipas këtij ligji shkaqet lidhen, krahas të tjerave, me lloj veprash penale të kryera, ose masa dënimi penal të marra në kohë të ndryshme nga subjekti vetëdeklarues.

Për zotin Hajdari nuk rezulton të ketë ndonjë vendim penal në Republikën e Shqipërisë. Për të rezulton që të ketë një vendim gjyqësor penal në shtetin grek. Sipas këtij vendimi, zoti Hajdari është fajtor për veprën penale *“Kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror”*, e parashikuar nga neni

298 i Kodit tonë Penal. Për këtë veprë penale atij i është dhënë si dënim *“Masa riedukuese e qortimit..”*.

KQZ-ja nuk ka kompetencë të vlerësojë llojin e veprës penale, llojin e sanksionit dhe të masës së dhënë ndaj një subjekti sipas një vendimi të marrë nga një organ procedural i huaj. Neni 8 i ligjit nr.138/2015 ka përcaktuar se në këtë rast është organi i prokurorisë ai që bën verifikimin e të dhënave.

Prokuroria e Përgjithshme ka konstatuar se subjekti i verifikimit, zoti Kreshnik Hajdari, ka kryer veprën penale të *“Hyrjes në territorin grek pa ruajtur formalitetet ligjore përkatëse”*, sipas ligjit 1975/1991 të shtetit grek. Kjo veprë penale është parashikuar si *“Kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror”* nga neni 298 i ligjit nr.7895, datë 27.1.1995 *“Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar.

Neni 2 i ligjit nr. 138/2015 *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”* ka përcaktuar në tërësinë e vet rastet e ndalimit të ushtrimit të një funksioni publik, të cilat lidhen me disa vepra penale pavarësisht masës së dënimit, ose me masë dënimi penal me heqje lirie, pavarësisht llojit të veprës penale. Në rastin konkret nuk përmbushet asnjë nga kriteret e përcaktuara sa më sipër, pasi zoti Kreshnik Hajdari nuk është gjendur fajtor për kryerjen e një krimi dhe as është dënuar me burgim për kryerjen e një krimi. Neni 2 i ligjit nr. 138/2015 nuk e parashikon veprën penale *“Kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror”*, të parashikuar nga neni 298 i Kodit Penal që të përfshihet në fushën e ndalimit për kandidim dhe për t’u zgjedhur në një funksion të lartë publik.

Në lidhje me pretendimin që zoti Kreshnik Hajdari është dëbuar nga territori i shtetit grek, rezultatet e verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme nuk e përmbajnë një fakt të tillë. Për më tepër neni 2, shkronja *“b”*, i ligjit nr. 138/2015 përcakton dëbimin si shkak ndalues për të kandiduar për t’u zgjedhur rastin kur dëbimi nga shtetet e përcaktuara në ligjin në fjalë është bërë për një kategori të caktuar veprash penale, të parashikuara në pikën 1, shkronjat *“a”*, *“b”* dhe *“c”* të këtij neni, apo janë dëbuar për cenim shumë të rëndë dhe serioz të sigurisë publike të shtetit përkatës.

Vepra penale për të cilën subjekti Kreshnik Hajdari është dënuar e për të cilën për momentin do të pranohet se ai ishte dëbuar, nuk përfshihet në rrethin e veprave penale për të cilat subjekti mund të jetë dëbuar nga vendet e listës të përcaktuar me vendimin e Kuvendit.

(6)

Gjithashtu, KQZ-ja vlerëson se nuk qëndron edhe pretendimi se zotit Kreshnik Hajdari duhet t’i ndërpritet mandati pasi ai nuk ka përmbushur detyrimin për deklaram të dënimit në shtetin grek. Ky detyrim për qëndron pavarësisht faktit se vepra penale për të cilën zoti Kreshnik Hajdari është shpallur fajtor në Greqi dhe pavarësisht se lloji i sanksionit penal në vetvete nuk përbën shkaqe ndaluese për të kandiduar apo për të ushtruar detyrën e kryetarit të bashkisë, pretendon pala e përfaqësuesve të Partia e Lirisë.

KQZ-ja vlerëson se ky pretendim nuk ka bazë ligjore.

Neni 5, pika 1, i ligjit nr. 138/2015 përcakton se *“Personat e parashikuar nga nenet 2 dhe 3 të këtij ligji duhet të plotësojnë e të nënshkruajnë një formular vetëdeklarimi me anë të të cilit*

deklarojnë mosekzistencën e shkaqeve për të kandiduar, për të mos u zgjedhur ose emëruar". Në kuptim logjik, por edhe tjetër të kësaj dispozite, një subjekti vetëdeklarues i kërkohet që ai vetë të deklarojë se nuk ka asnjë shkak që ai të pengohet, në rastin në shqyrtim, të jetë kandidat për kryetar bashkie, apo edhe kryetar bashkie. Ose nëse ka një shkak të tillë, ka detyrimin ta deklarojë atë shkak. Kjo do të thotë se duhet të deklarohen vetëm shkaqet që e ndalojnë kandidimin. Nëse shkaqet mungojnë, atëherë subjekti nuk ka asnjë detyrim të deklarojë çdo gjë tjetër që nuk përbën shkak/ndalim për të marrë një funksion publik.

Ligji nr.138/2015 nuk parashikon në asnjë dispozitë të tij, as direkt dhe as indirekt, detyrimin e subjektit vetëdeklarues për të deklaruar gjithçka.

Subjekti vetëdeklarues, zoti Kreshnik Hajdari, u është përgjigjur me "Jo" të gjitha pyetjeve të formularit të vetëdeklarimit. Kjo do të thotë se ai në përputhje me parashikimin e pikës 1 të nenit 5 të ligjit nr. 138/2015 ka deklaruar "*... mosekzistencën e shkaqeve për të kandiduar, për të mos u zgjedhur...*". E sikurse arsyetuar më sipër, konsideruar edhe vendimin e dhënë nga gjykata e shtetit grek, nuk ka asnjë shkak që e ndalon atë të kandidonte, apo të ushtrojë detyrën e kryetarit të bashkisë.

Referimi si mbështetje të pretendimit për të deklaruar çdo fakt penal tek vendimi nr. 215, datë 24.7.2023 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, e cila në këtë vendim ka arsyetuar se "*...subjektet vetëdeklaruese kanë detyrim të pasqyrojnë në formular çdo dënim penal të formës së prerë*", është jo relevant. Në thelb ky vendim i mësipërm nuk ka rrethana dhe fakte të ngjashme me çështjen objekt gjykimi, për këtë arsye nuk mund të na orientojë dhe as të merret për analogji.

Por edhe nëse vendimin e mësipërm të Gjykatës së Lartë e shohim si relevant në këtë diskutim, KQZ-ja vlerëson se ai vendim nuk kundërshton arsyetimin e KQZ se jo çdo fakt penal duhet të deklarohet në kuptim të ligjit nr.138/2015. Nëse ekziston një fakt penal i detyrueshëm për tu deklaruar (vendimi penal në rastin në diskutim), po atëherë subjekti ka detyrimin për ta deklaruar, ashtu sikurse dhe Gjykata e Lartë urdhëron. Por nëse ky dënim (vendim penal) në kuptim të ligjit penal dhe/ose të ligjit nr. 138/2015 nuk ekziston, atëherë çfarë duhet të deklarojë subjekti vetëdeklarues?!!!!

Qëllimi i ligjit nr. 138/2015 nuk është të vlerësojë "sinqeritetin" e kandidatit. Qëllimi i këtij ligji është të ndalojë të marrin një zyrë publike (të kandidojë për të kur është rasti) këdo që në *curriculum*-in e tij ka "probleme" me ligjin penal, sipas kriterëve të përcaktuara nga vetë ligji nr. 138/2015. Nëse subjekti nuk i ka këto "probleme", ky ligji (nr.138/2015) e konsideron atë të denjë të konkurrojë për t'u zgjedhur apo të ushtrojë një funksion publik, pra nuk e vendos në kushtet e ndalimit për këtë rast.

KQZ-ja ka mbajtur një qëndrim të njëjtë në lidhje me këtë diskutim edhe në raste të tjera të ngjashme.

Ky qëndrim është mbajtur nga KQZ në vendimin nr. 422, datë 2.7.2021, "Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetëdeklarues, zotin Qerim Ismailaj", i lënë në fuqi nga KAS me vendimin nr. 101, datë 07.07.2021, lënë në fuqi nga Gjykata e Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. 815, datë 16.3.2022.

Ky qëndrim është mbajtur me vendimin nr. 329, datë 1.5.2021, “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetëdeklarues, zotin Napoleon Laska”.

Po ky qëndrim është mbajtur nga KQZ-ja me vendimin nr. 338, datë 4.5.2021, “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetëdeklarues zotin Zef Hila”.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 90 dhe 95 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të kreut V të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

V E N D O S A:

1. Konstatimin se zoti Kreshnik Riza Hajdari, kryetar i Bashkisë Kuçovë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, nuk përfshihet në kushtet e ndalimit për të ushtruar funksionin publik të Kryetarit.
2. Vazhdimin e mandatit të zotit Kreshnik Riza Hajdari, kryetar i Bashkisë Kuçovë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI